



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kačanik
01Nr. 104/02-13736/21
Kaçanik, 28.05.2021

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.10/03 Prill 2019), neni 6 par.1 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 Për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Vendimit Paraprak për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë 01Nr.16-4996/2016 të datës 18/02/2016 dhe Vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit paraprak 01Nr.104-2-9777/2017 të datë 28/04/2017, të Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-13736/2, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 28 Maj 2021 mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE KOMUNALE
TË CILAT DO TË JEPEN NË SHFRYTËZIM NË VITIN 2021

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Lista e Veçantë e pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2021, si vijon:

1.1 Zona kadastrale Begracë:

1. Parcela kadastrale, nr. 01580-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 02.33.79 ha;
2. Parcela kadastrale, nr. 01579-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.64.80 ha;
3. Parcela kadastrale, nr. 02706-1, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.61.44 ha;
4. Parcela kadastrale, nr. 02706-3, në sipërfaqe të tërsishme prej 02.09.05 ha;
5. Parcela kadastrale, nr. 02706-4, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.11.39 ha;
6. Parcela kadastrale, nr. 02706-5, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.61.42 ha.

1.2 Zona kadastrale Doganaj:

1. Parcela kadastrale, nr. 00143-1, në sipërfaqe të tërsishme prej 01.87.77 ha;
2. Parcela kadastrale, nr. 00143-2, në sipërfaqe të tërsishme prej 01.50.01 ha;
3. Parcela kadastrale, nr. 00143-3, në sipërfaqe të tërsishme prej 01.49.95 ha.

1.3 Zona kadastrale Kaçanik i Vjetër:

1. Parcela kadastrale, nr. 00401-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 03.45.94 ha.

2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të kësaj liste, **është për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe përmbushjes së interesit të përgjithshëm të qytetarëve.**

3. Lista e veçantë e pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2021 të përcaktuara si në këtë vendim, do të bëhet publike në Faqen Zyrtare të Komunës.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi do Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

Nr. 020-488/3
Data 15.06.2021

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Zyrtaret përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01Nr.104/02-13736/21, për aprovimin e listës së veçantë të pronës komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2021.
I miratuar më datë: 28.05.2021
I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 31.05.2021

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.